

Informacion kryesor për investitorin

Ky dokument ju paraqet informacionin kryesor për investitorin në lidhje me Fondin. Ky nuk është informacion marketingu. Ky informacion kërkohet nga rregullorja nr 97, datë 25.06.2014, "Për informacionin kryesor që duhet t'i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive", ndryshuar, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet e lidhura me investimin në Fond. Përpara se të merrni vendimin për të investuar, ju këshillojmë ta lexoni me vëmendje këtë informacion.

Kuatat e Fondit nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në fondin Raiffeisen Vizion nuk është i garantuar, fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe rreziku i humbjes së principaltit përballohet nga investitori.

FONDI I INVESTIMIT RAFFEISEN VIZION - Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, administrohet nga Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Objektivi dhe Politika e Investimit*

Objektivi

Objektivi i investimit të Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm për investitorët, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Kategoritë kryesore të instrumenteve financiarë

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi investon deri në 100% të aseteve të tij në tituj borxhi qeveritar, të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë; deri në 10% në fonde investimi me fokus në tituj borxhi; deri në 20% në ekuivalente cash-i, transaksione të anasjellta të riblerjes dhe depozita bankare me maturitet deri në 12 muaj.

Në përputhje me kërkesat e strategjisë së investimit, fondi mund të investojë gjithashtu edhe në instrumente borxhi të emetuara nga organet e qeverisjes vendore dhe shoqëri tregtare vendase, të tregtuara në tregje të rregulluara ose bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë deri në 10% të aseteve.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve në obligacione afatgjatë të Qeverisë shqiptare.

Fondi përcakton natyrën e investimeve të aseteve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Shitja e kuotave

Shitja e kuotave të fondit mund të bëhet në çdo kohë nga ana e investitorit me kërkesë të tij, dhe shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh.

Vlera minimale e mbajtur në Fond është 10,000 lekë. Në rast të një balance më pak se 10.000 lekë, llogaria e investitorit mund të mbyllet.

Të gjitha shitjet e kuotave të bëra brenda 2 viteve nga data e blerjes së tyre, do të jenë subjekt i një tarife dalëse.

Faktorët që mund të ndikojnë në performancën e fondit

Performanca e Fondit dhe rrjedhimisht edhe vlera e investimit mund të luhet në varësi të kushteve të tregut. Luhatja e normave të interesit të instrumenteve financiare në të cilat fondi investon është faktori kryesor i cili ndikon në performancën e fondit. Rritja e normave të interesit të instrumenteve financiarë ndikon negativisht duke ulur vlerën e investimeve dhe anasjelltas.

Kostot e investimit nuk kanë ndikim mbi performancë sepse ato mbulohen nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest.

Horizonti i Investimit

Në mënyrë që të arrihen objektivat e performancës së fondit, minimumi i rekomanduar për horizontin e investimit është 3 vjet. Duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit, ky horizont do të rriste mundësinë për një kthim optimal nga investimi. Një tarifë dalëse do të aplikohet për çdo investim të mbajtur në fond për më pak se 2 vjet.

Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një menyrë investimi afatmesme dhe afatgjatë me qëllim sigurimin e një kthimi të kenaqshëm dhe diversifikimin e aseteve. Qëndrimi shumë i shkurtër në fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm.

Të ardhurat nga investimi

Të ardhurat e fondit nuk shpërndahen por ri-investohen.

**Për më tepër informacion mbi objektivat e investimit jeni të lutur ti referoheni prospektit të Fondit Raiffeisen Vizion.*

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta

1

2

3

4

5

6

7

Domethënia e rregjesit të rrezikut sintetik dhe përfitimit

Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit ka për qëllim ti japë investitorit një ide mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e rregjesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen. Luhatshmëria e tregjeve financiare ndikon në performancën e fondit dhe kjo mund të sjellë ndryshimin e këtij treguesi në të ardhmen.

Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë.

Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.

Kategoria e rrezikut e Fondit Raiffeisen Vizion

Fondi investon kryesisht në bono dhe obligacione të qeverisë shqiptare. Si rrjedhojë e natyrës së investimeve, kryesisht në instrumenta borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria shqiptare, fondi ka një profil rreziku të lidhur ngushtë me profilin e rrezikut të qeverisë shqiptare. Duke qenë se fondi investon kryesisht në instrumente afatgjatë, të cilët janë subjekt i një luhatshmërie më të lartë në vlerë, niveli i rrezikut të fondit është mesatar. Profili i parashikuar i rrezikut të fondit i përket kategorisë së tretë të tregjesit të rrezikut sintetik dhe përfitimit. Ky nivel i tregjesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.

Rreziqe me rëndësi materiale të cilat nuk mbulohen tërësisht nga treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit:

Rreziku i likuiditetit: rreziku që një aset të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafert me vlerën e tregut. Tregu sekondar i bonove dhe obligacioneve të qeverisë shqiptare konsiderohet një treg me aktivitet të kufizuar.

Rreziku i palës tjetër: rreziku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Gjithashtu ky rrezik lidhet me mundësinë që pala tjetër të mos jete në gjendje të realizojë pagesat sipas kushteve të një marrëveshjeje apo transaksioni të paracaktuar.

Rreziku i kreditit: ky rrezik lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aseteve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit. Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që rreziku i kredisë të përjashtohet plotësisht.

Rreziku operacional: rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese.

KOSTOT DHE PAGESAT

Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit Raiffeisen Vizion. Keto pagesa reduktojnë rritjen potenciale të investimit tuaj. Pagesat mund të jenë subjekt ndryshimi.

Tarifa e hyrjes dhe daljes nga Fondi:

- Tarifë hyrëse : 0.00%
- Tarifë dalëse : 2.00% e Vlerës së kuotave të shitura

Tarifë dalëse aplikohet vetëm nëse nuk plotësohet kushti i periudhës minimale të qëndrimit në fond për 2 vjet.

Të gjitha të ardhurat nga kjo tarifë qendrojnë në fond dhe do të shpërndahen si të ardhura për të gjithë anëtarët e mbetur të fondit në përpjesëtim me shumën që ata kanë investuar në fond.

Tarifë vjetore: Tarifa e Administrimit 1.25% në vit e Vlerës Neto të Aseteve

**Të gjitha pagesat e tjera si ato të bankës depozitare, autoritetit rregullator, shit-blerjes së investimeve, marketingut dhe printimit përballohen nga Raiffeisen INVEST sh.a.*

**Për më tepër informacion rreth pagesave, jeni të lutur ti referoheni seksioneve 2.14 dhe 2.15 të prospektit të Fondit Raiffeisen Vizion.*

Fondi ka filluar aktivitetin më 20 Gusht 2018 dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme për t'i siguruar investitorëve të Fondit një tregues për performancën e kaluar.

Informacion Praktik

- Banka Depozitare është Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecurisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, si dhe pranë degëve të Raiffeisen Bank sh.a.
- Çmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, ku mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Ju lutemi vini re që regjimi tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara, të cilat rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.
- Raiffeisen INVEST sh.a. mund të konsiderohet përgjegjëse për informacionin e këtij dokumenti vetëm nëse ai është i pavërtetë, i pasaktë ose i ndryshëm nga ai që përmban prospektin e fondit.

Ky fond është i licencuar në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Raiffeisen INVEST sh.a është e licencuar në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky informacion kryesor për investitorin është i saktë në datën 20 Gusht 2018.